

NewsLetter



AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE
DHOMA AMERIKANE E TREGTISË

THE OFFICIAL NEWSLETTER OF THE AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE IN ALBANIA

AMCHAM LAJME

AmCham dhe Revista Monitor organizojnë Konferencën:

"Ristrukturimi Ekonomik për një Perspektivë të Re"

Në faqen **2**

Arbitrazhi Tregtar, ekspertët prezantojnë veçoritë e ligjit

05

Gjenerata Z, zhvillimi i potencialit rinor në dobi të biznesit

06

Praktikat e punës si formë e bashkëpunimit mes biznesit dhe sistemeve universitare

07

Ekspertët diskutojnë: Struktura e kompanisë, qartësia e pozicioneve të punës dhe kualifikimeve

08

Dhoma Amerikane organizon për anëtarët Seminarin mbi Ligjin e Tatimit mbi të Ardhurat

09

CEO Forum ul në tryezë drejtuesit e AmCham dhe Ministrin e Financave z. Mete

10

Potenciali i DFC dhe mundësitë e bashkëpunimit me biznesin në Shqipëri

12

KOMITETET NË AMCHAM
Inteligjenca Artificiale dhe inovacioni si e ardhmja e biznesit, Sfidat në aplikimin e AI Zbatimi i Ligjit të Tatimit për të Ardhurat, çfarë duhet të dinë bizneset

14

AMCHAM & UNIVERSITETET
Organizohet konkurrencioni "Young Innovators", në kuadër të përmbijljes së lëndës së Inovacionit Dita e Karrierës në Shkollën e Mesme të "New York"-ut

18

Dhomat Amerikane në Europë: Ndërlidhësit e biznesit mbledhen në Washington

04

SPECIALE EKONOMIKE

Inovacioni & Digjitalizimi



SIGURIA DHE ROLI KRYESOR I SEKTORIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT (ICT) NË RITJEN EKONOMIKE

Grant Van Cleve
Prodigy Shpk
President i AmCham Albania

Në faqen **19**



NDRYSHIMI I KONCEPTIT EDUKUES PËR TEKNOLOGJINË NË SHQIPËRI

Admir Malaj
Beta Plan

Në faqen **21**



BANKINGU I HAPUR NË SHQIPËRI. Çfarë ndodhi pas afatit të 30 qershorit?

Linda Shomo
Easy Pay
Kryetare e Komitetit të Biznesit Digjital

Në faqen **23**



NDIKIMI I PLATFORMAVE ERP NË ZHVILLIMIN E INOVACIONIT NË SHQIPËRI

Gentian Likaj
Communication Progress

Në faqen **25**



Konferenca "Ristrukturimi Ekonomik për një Perspektivë të Re" e AmCham dhe Revista Monitor

Konferenca e AmCham dhe Revistës Monitor "Ristrukturimi Ekonomik për një Perspektivë të Re" zhvilloi një platformë të shkëmbimit të ideve mbi mënyrën më të mirë të rrugëtimit të ekonomisë shqiptare.



Konferenca ekonomike kishte për qëllim të ofronte informacion të përditësuar përmes raporteve nga AmCham dhe Monitor mbi çështjet kyçe që prekin klimën ekonomike dhe propozimet inovative për një perspektivë të re.

Diskutimet u përqëndruan rreth Indeksit të Biznesit dhe gjetjeve të tij, duke u fokusuar në mënyrën se si bizneset identifikojnë dhe japin përparësi çështjeve që ndikojnë në klimën ekonomike. Prioritetet e vendosura nga perceptimi i tyre u bënë objekt i diskutimit mes përfaqësuesve të qeverisë, Parlamentit, organizatave ndërkombëtare dhe analistë ekonomikë, ku secili në këndvështrimin e vet ndërtuan një mozaik të perspektivës ekonomike.

"Kemi pasur një përmirësim të Indeksit, por ende jemi nën kufirin prej 50. Ka gjëra për të cilat duhet të shqetësohemi si fuqia punëtore, prakti-



kat monopol apo informaliteti etj", - tha në përsëritjet e tij Presidenti i AmCham Albania Grant Van Cleve i cili vendosi theksin në punën që bën organizata përmes Komiteteve dhe ekspertizës së tyre për të diagnostikuar fenomene dhe për të propozuar zgjidhje.

Në përsëritjet e tij Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Blendi Gonxhja u shpreh se "Ndonëse Indeksi tregoi përparime, problemet si mungesa e fuqisë punëtore infrastruktura jo optimale, korrupsioni, burokracitë, mbeten në krye të axhendës sonë të punës",

deklaroi Blendi Gonxhja, Ministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit – duke përmendur në të njëjtën kohë se ka zhvillime pozitive në marrëdhëniet tregtare mes dy vendeve të cilat kanë arritur nivelin më të lartë ndonjëherë, duke i kaluar 100 milionë dollarë, me një bilanc në favor të Shqipërisë. "Këto konfirmojnë momentin e mirë të ekonomisë shqiptare me rritjen më të lartë në rajon. Shqipëria është bërë një vend që po tërheq investitorët e huaj. Por jo çdo gjë që shkëlqen është flori. Jemi në dijeni për shqetësimet e bizneseve" – u shpreh z.Gonxhja.

Dy sesionet e konferencës të drejtura nga Arlinda Çaushtolli, kanë patur si kryefjalë të diskutimit tema që përfshijnë informalitetin, fuqinë e kualifikuar punëtore, monopolet dhe nivelet e taksave, të cilat vazhdojnë të kufizojnë mundësitë për rritje dhe ndikojnë negativisht tek bizneset.

Në sesionin e parë Zv.Ministri i Ekonomisë Sokol Duma, Kryetarja e Komisionit Parlamentar të Integrimit Jorida Tabaku, Përfaqësuesja e BERZH Ekaterina Solovova, Akademiku Arben Malaj, nxitën një diskutim të stimuluar nga Indeksi Biznesit i AmCham i prezantuar nga Drejtori Ekzekutiv Neritan Mullaj. Për herë të parë në 11 vjet është arritur niveli më i lartë prej 47.57 pikë dhe e rëndësishme është që trendi vazhdon pozitiv. Por jemi ende në zonën e nxehtë pasi indeksi është ende nën 50 pikë”, deklaroi z.Mullaj.

Duke komentuar rezultatin z. Arben Malaj ekspert i ekonomisë, ish-ministër i Financave komentoi se “Koncepti nën 50 pikë nënkupton që është një element shtypës që nuk e lejon ekonominë të zhvillohet. Tre problemet kryesore të Shqipërisë kanë qenë pronat, gjyqësori, korrupsioni”.

Opinionin e vet në lidhje me indikatorin e fuqisë punëtore dhe impaktin e saj në ekonomi, e ka dhënë dhe parlamentarja znj. Jorida Tabaku e cila u shpreh se “Shqetësimet e biznesit në 10 vitet e fundit janë të njëjta që do të thotë që diçka nuk shkon. Shqetësimi kryesor lidhet me problemin e fuqisë punëtore që është i lidhur me largimin e shtresës së mesme”, tha znj. Jorida Tabaku.

Mjaft konstruktiv ka qënë edhe diskutimi i përfaqësues së BERZH znj. Ekaterina Solovova e cila ka shprehur qëndrimin e institucionit duke thënë se “Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim përdor mekanizmat financiarë për të mbështetur tranzicionin drejt një ekonomie të qëndrueshme që mbështetet në politika që nxisin inovacionin”

Diskutimi vazhdoi në sesionin e dytë ku Ornella Liperi, Kryeredaktore e Revistës Monitor, prezantoi gjetjet e Pyetësorit për Informalitetin duke hapur një diskutim mes ekspertëve mbi ndikimin e tij në ekonomi dhe zgjidhjet që vijnë prej politikave adekuate. Rreth 61% të anketuarve thanë se informaliteti në ekonomi është rritur gjatë vitit të



fundit, përkundrazi 29% që pohuan se nuk ka ndryshuar dhe vetëm 9% që pohuan se është ulur. Pjesë e këtij paneli diskutimi ishin z.Grant Van Cleve, President i AmCham, znj.Diana Leka (Angoni) nga Këshilli i Investimeve, dhe z.Adrian Shehu Kryetar i Komitetit të Investimeve në AmCham.

ÇFARË TREGOI INDEKSI AMCHAM KËTË VIT

Indeksi Biznesit ka shënuar një tjetër rritje të rëndësishme në 2023 prej 4.16 pikësh duke vendosur rezultatin më të lartë në 11 vitet e fundit prej 47.57 nga 100 pikë të mundshme. Ka reflektuar një perceptim optimist të komunitetit të AmCham, por që në vlerësimin e tyre objektiv nuk e ka kaluar nivelin e 50 për qindshit duke mbetur në zonën e nxehtë që simbolizon ngjyra e kuqe.

Indeksi i Biznesit mat perceptimin e biznesit për 27 indikatorë makro. Në tabelën e përgjithshme çdo vit vihen re disa indikatorë që marrin vlerësim pozitiv në rritje.

E veçanta e këtij viti është se anëtarët e AmCham kanë vlerësuar me një rritje të madhe indikatorin e performancës së ekonomisë shqiptare +13.99 pikë. Ky rezultat bëhet edhe më i qartë kur vë re korrelacionin për klimën e biznesit që ka shënuar një rritje prej +5.02 pikë.

Ndërkaq anëtarët kanë shprehur përmes vlerësimit shqetësimin për “Siguria për financime në zhvillimin e biznesit” i cili ka shënuar një ulje prej 0.02 pikë apo “Kërkesa për mallra e shërbime për Eksport” që ka pësuar një ulje -3.29 pikë. Vihet re se pas dy viteve me një vlerësim pozitiv në marrëdhëniet me institucionet, “Marrëdhëniet me Tatimet” ka pësuar një ulje të lehtë prej -0.31.

Janë pesë çështje themelore që vazhdojnë të mbeten në zonën e nxehtë të Indeksit të Biznesit. Gjetja e forcave të kualifikuara, monopoli dhe konkurrenca e pandershme, informaliteti, burokracia qeveritare dhe niveli i taksave, janë pesë çështjet në krye të listës së shqetësimeve të anëtarëve të AmCham.

Indikatorin e “Gjetjes së forcave të kualifikuara të punës” ka një përmirësim të lehtë këtë vit me dy pikë. Por 74 për qind e të anketuarve e kanë vlerësuar si të vështirë gjetjen e punonjësve. Ndërkaq Informaliteti ka një vlerësim të ulët vetëm 35.71 pikë nga 100 të mundshme.

Dhomat Amerikane në Europë: Ndërlidhësit e biznesit mbledhen në Washington

Marrëdhëniet transatlantike kanë qënë në fokus të axhendës ambicioze të Delegacionit të Dhomave Amerikane në Europë gjatë vizitës në Washington. Pjesë e këtij delegacioni së bashku me 40 Drejtorë Ekzekutivë nga 30 AmCham në Europë, ishte edhe Drejtori Ekzekutiv i AmCham Albania, Neritan Mullaj. Porta e parë ku kanë trokitur Dhomat Amerikane në Europë (ACE) ka qënë ajo e Dhomës Amerikane të Tregtisë në Washington, ku janë pritur nga Presidentja dhe CEO, Suzanne Clark. Diskutimi ka përfshirë tema të rëndësishme të bashkëpunimit si ekonomia, gjeopolitika dhe çështjet transatlantike.

Vizitat në Departamentin e Shtetit dhe Departamentin e Tregtisë i kanë dhënë mundësinë Dhomave Amerikane të flasin për zhvillimin e rrugëve tregtare me Marisa Lago, nënkryetare e Tregtisë për Tregtinë Ndërkombëtare, Departamenti i Tregtisë i SHBA, si edhe Dilaë ar Syed, Zëvendës Administrator në Administratën e Biznesit të Vogël të SHBA.

Mjaft interesante dhe në shërbim të rrjetëzimit të Dhomave Amerikane, ka qënë pritja e organizuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian, ku ka patur mjaft diskutime mbi Raportin e Ekonomisë Transatlantike 2024, duke theksuar rëndësinë e marrëdhënieve në nivel të lartë dhe ndërveprimet mes biznesit.

Gjatë ditës së dytë, përfaqësuesit e ACE janë angazhuar në Samitin e Çështjeve Transatlantike të Bizne-



sit, i cili u përqëndrua në përmirësimin e konkurrueshmërisë ekonomike, zhvillimet dixhitale dhe teknologjike dhe kalimin në energjinë rinovuese. Grupi i ACE u angazhua në një diskutim në Departamentin e Shtetit të SHBA-së dhe në Këshillin e Atlantikut, duke sjellë perspektivën e vet në lidhje me klimën politike dhe politikat tregtare. Në Departamentin e Shtetit të SHBA-së, delegacioni pati një dialog konstruktiv me Ambasadorin Yuri Kim, Zëvendës Sekretare e Parë për Punët Evropiane dhe Euraziatike, i fokusuar në gjendjen e marrëdhënieve transatlantike dhe prioritetet e Byrosë për Punët Evropiane dhe Euroaziatike. Ambasadorja Yuri theksoi se SHBA dhe Evropa duhet të punojnë së bashku gjatë këtyre sfidave historike. Sektorët për bashkëpunim më të madh përfshijnë Energjinë, AI-në, Sigurinë Kibernetike, Rrjetin e Furnizimit dhe Mbrojtjen.

Në Miami, ekipi i ACE u takua me Dhomen e Tregtisë së Miami, duke zbuluar mundësitë e bashkëpunimit të biznesit. Pjesë e takimeve ishin edhe vizitat tek Grupi i Royal Caribbean, duke u përqëndruar në përparimet e turizmit dhe format e qëndrueshmërisë. Ndërsa përfundimtare ishte tek Hotel South Beach, ku u vendos theksi në promovimin

e ekonomisë qarkulluese dhe përpjekjet për të rritur përdorimin e elementëve të riciklueshëm edhe në industrinë e turizmit.



JAVA E ARBITRAZHIT, DHOMA AMERIKANE TRAJNON ANËTARËT,

Arbitrazhi Tregtar, ekspertët prezantojnë veçoritë e ligjit

ICC (Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë) po nxit një traditë me Javën e saj të Arbitrazhit, duke angazhuar aktorë të ndryshëm për të promovuar praktikën jetike të arbitrazhit në biznes.

Për të eksploruar ndikimin e arbitrazhit në aktivitetet e biznesit, Dhoma Amerikane organizoi një aktivitet trajnimi të fokusuar në Arbitrazhin Tregtar dhe specifikat e tij. Trajnimi u drejtua nga dy avokate, Merlin Papadhopulli dhe Xhilda Vocaj, të cilët ndanë ekspertizën e tyre nga praktika e tyre ligjore ndërkombëtare në Francë.

“Për vite me radhë, Dhoma Amerikane ka kontribuar në konsultimet publike nëpërmjet ekspertëve tanë më të mirë, duke mbrojtur arbitrazhin si një metodë efektive alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Dhoma Amerikane njeh rolin e rëndësishëm

të Ligjit të Arbitrazhit për bizneset vendore dhe investitorët e huaj”, tha në fjalën e tij përshëndetëse Drejtori Ekzekutiv Neritan Mullaj.

Ligji i ri trajton pasiguritë e mëparshme ligjore me të cilat përballshin bizneset gjatë hartimit të kontratave apo zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Ai gjithashtu ofron garanci dhe besim për investitorët e huaj se ata mund të zgjidhin mosmarrëveshjet përmes arbitrazhit në nivel lokal ose që të drejtat e tyre të njihen nga gjykatat ndërkombëtare të arbitrazhit.

Arbitrazhi ofron një alternativë efikase për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë sistemit gjyqësor, duke ofruar fleksibilitet, efikasitet në kohë

dhe kosto, vendime autoritative dhe konfidencialitet.

Gjatë prezantimit, ekspertët Papadhopulli dhe Vocaj i ilustruan këto përfitime me shembuj praktikë, duke detajuar procesin e arbitrazhit nga përzgjedhja e arbitrave deri te finalizimi i marrëveshjeve. Ata gjithashtu adresuan pyetje të shumta në lidhje me zbatimin e vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar dhe protokollet dhe konventat që rregullojnë këtë proces.

Trajnuesit shpjeguan se vendet që praktikojnë arbitrazhin kanë unifikuar ligjet e tyre të arbitrazhit vendas dhe ndërkombëtar, duke përfshirë Konventën e Nju Jorkut dhe rregullat e Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Tregtisë Ndërkombëtare (UNCITRAL). Ky harmonizim u pasqyrua edhe në ligjin shqiptar të arbitrazhit, duke e përafëruar atë me standardet ndërkombëtare.



DITA E PARË / Java e Hapur e Burimeve Njerëzore në AmCham

Gjenerata Z, zhvillimi i potencialit rinor në dobi të biznesit

Ka nisur Java e Hapur e Burimeve Njerëzore ku për tre ditë, tre kompani janë bashkuar në AmCham me ekspertë të Burimeve Njerëzore për të ndarë praktikat më të mira në zhvillimin e kapitalit njerëzor në tre tema të ndryshme.

U fillua me një temë mjaft interesante mbi tërheqjen dhe mbajtjen në punë të punonjësve të Gjeneratës Z. Spartak Alibali, Menaxher i Burimeve Njerëzore në Deloitte Albania & Kosovo, i ka referuar për anëtarët e Dhomës Amerikane, mbi karakteristikat e kësaj gjenerate dhe veçoritë që duhet të njihen nga departamentet e Burimeve Njerëzore për t'i ndihmuar të zhvillohen dhe të bëhen një aset i çmuar për kompaninë.

Krijimi i një klime të përshtatshme për ta trajtuar punonjësën si aset më me vlerë i kompanisë, është sfida më të cilën përballen departamentet e burimeve njerëzore. Raporti i fundit i Deloitte, ka hedhur dritë mbi prirjet dhe vlerat që kompanitë po përqafojnë për të qënë të suksesshëm përmes kapacitetit të stafëve të tyre.

“Burimet njerëzore po bëhen të rëndësishme për kompanitë. Nga departamente operationale ato po kthe-

hen në departamente këshilluese për lidhshpimin dhe objektivat që duhet të vendosë kompania duke u mbështetur në kapacitetet njerëzore” – tha gjatë trajnimit Spartak Alibali.

Vlerësimi i talenteve, krijimi i një forme të hapur të komunikimit, vendosja e objektivave të drejta, përqafoimi i një kulture bashkëpunuese, janë elementë që Burimet Njerëzore këshillojnë si forma të nevojshme për të arritur suksesin.

Objektivat e organizatës bëhen më të arritshme kur ato përputhen me objektivat personale. Si mund t'ia arrijnë Burimet Njerëzore të krijojnë këtë ndërveprim me Gjeneratën Z dhe të përfitojnë nga potenciali i tyre, ka qënë dhe fokusi i diskutimit mes z. Alibali dhe anëtarëve të AmCham. Gjenerata Z e cila po pushton sot intervistat e punës, reflekton me karakteristikat e saj një prirje të re të sjelljes.

Spikasin si biznesmenë, telefoni është mjete që nuk harrojnë kurrë,

vlerësojnë pavarësinë financiare, mësojnë shpejt dhe pëlqejnë të jenë të vlerësuar. Një gjeneratë që i pëlqen të ketë ndikim pozitiv tek ambjenti dhe vendosin një balancë mes punës dhe jetës. Ndërsa menaxherët e burimeve njerëzore punojnë për t'i zhvilluar si kapacitete, sfida që po shfaqet është mbajtja e tyre në punë. Matja e produktivitetit përmes disa indikatorëve dhe metrikave të cilat duhet të organizohen në bashkëpunim me punonjësit në mënyrë që të jenë objektive, apo përdorimi i inovacionit dhe formeve të AI për të lehtësuar punën e tyre, janë të këshillueshme, kur ndërvepron me këtë gjeneratë.

Anëtarët e Dhomës Amerikane kanë bërë një diskutim të hapur mbi përvojat që ata kanë me këtë gjeneratë, dhe mendimin e tyre se si duhet të trajtohen për të përfituar potencialin e plotë të tyre.



DITA E DYTË / Java e Hapur e Burimeve Njerëzore në AmCham

Praktikat e punës si formë e bashkëpunimit mes biznesit dhe sistemeve universitare

Dita e dytë e Javës së Hapur në AmCham ka mirëpritur z.Elvin Nosi, Drejtor i Burimeve Njerëzore në Grupin Balfin, i cili ka drejtuar diskutimin mbi format e praktikës së punës dhe bashkëpunimin me sistemet universitare.

Praktikat e punës është një proces që shoqërohet me sfida nga të dy palët, pasi të rinjtë vijnë me ide dhe energji sfiduese për kompaninë, ashtu sikurse kompania teston nivelin e tyre të njohurive dhe aftësive që kanë. Kompanitë çdo ditë e më shumë po përqafojnë kulturën e praktikave mësimore dhe janë të vetëdijshme për përfitimet që sjell ky proces, duke e standartizuar si një proces rekrutimi.

Z. Nosi ka sjellë përvojat e Grupit Balfin kur ka folur për një rritje të ndjeshme të nivelit të kërkesave për praktika mësimore dhe jo vetëm nga sisteme universitare brenda vendit.

“Ne marrim rreth 1300 aplikime në vit dhe mundemi të pranojmë rreth 170 praktikantë, pasi ata kalojnë në procesin e përzgjedhjes dhe integrimin e tyre në kompani, duke përfshirë edhe trajnimin” – tha gjatë takimit El-



vin Nosi, Drejtor i Burimeve Njerëzore në Grupin Balfin.

Takimi ka patur diskutime shumë intensive që lidhen me mënyrën e trajtimit të praktikantëve, benefitet dhe format e shpërblimit për orët e tyre të punës. Kompanitë anëtare në takim, shprehën opinionin se format e rekrutimit dhe të trajtimit të praktikantëve janë pothuajse të njëjta me ato të stafeve, mbështetur në filozofinë se nesër ata mund të jenë punon-

jësit e ardhshëm të kompanisë.

Lidhja me sistemet universitare dhe zyrat e karrierës, është një tjetër sfidë me të cilën përballen bizneset. Është e nevojshme një rritje e bashkëpunimit biznes – universitete, jo vetëm për zhvillimin e praktikave mësimore, por edhe për ndikimin e programeve dhe kurrikulave të cilat i pajisin studentët me njohuri që i shërbejnë tregut të punës.



DITA E TRETË Java e Hapur e Burimeve Njerëzore në AmCham

Ekspertët diskutojnë: Struktura e kompanisë, qartësia e pozicioneve të punës dhe kualifikimeve

Dita e tretë e Javës së Hapur e Burimeve Njerëzore është drejtuar nga Elvis Kotherja, Kryetar i Komitetit të Turizmit në AmCham dhe është fokusuar në standardizimin e pozicioneve të punës dhe kualifikimet profesionale.

Gjatë takimit, Elvis Kotherja CEO i Elite Travel, ka theksuar se Departamentet e Burimeve Njerëzore luajnë një rol të rëndësishëm në krijimin e strukturave efikase brenda kompanisë duke krijuar profile të qarta të pozicioneve të punës dhe më pas, rekrutime të suksesshme. Ato kthehen në një mbështetje të fortë për funksionimin e mirë dhe të suksesshëm të kompanisë.

Në takim ka marrë pjesë edhe Drejtorja e Menaxhimit të AFP në AKPA, Etleva Gjellaj, e cila ka diskutuar me pjesëmarrësit mbi rolin e biznesit në përcaktimin e kualifikimeve për çdo pozicion pune. Kjo do të ndihmonte Agjencinë Kombëtare të Kualifikimeve dhe Aftësive në ndërtimin e profileve të qarta të pozicioneve të punës, të shprehura në sistemet ISCO përmes kodeve dhe ESCO, përmes kompetencave.



Znj Gjellaj informoi se Agjencia Kombëtare e Kualifikimeve dhe Aftësive po krijon Komitete me praninë e përfaqësuesve të biznesit për katër sektorë prioritarë të ekonomisë, turizmi, ndërtimi, energjia, dhe ICT. Roli i Komiteteve në bashkëpunim me specialistët e Agjencisë do të jetë ndihmues në standardizimin e çdo pozicioni pune në këto sektorë me kualifikimet përkatëse.

Gjatë diskutimit z. Kotherja përfshiu pjesëmarrësit në një diskutim aktiv mbi rolin që mund të luajnë së bashku në zhvillimin e kurrikulave për shkollat profesionale dhe sistemet universitare. Bashkëpunimi i biznesit me shkollat është themelore në kohën kur tregu i punës jo vetëm që ka nevojë për kapital njerëzor, por edhe të kualifikuar sipas sektorëve.



PËRQASJA NDAJ NDRYSHIMEVE:

Dhoma Amerikane organizon për anëtarët Seminarin mbi Ligjin e Tatimit mbi të Ardhurat

Dhoma Amerikane e Tregtisë (AmCham) organizoi një Seminar mbi Ligjin e Tatimit mbi të Ardhurat, i iniciuar ekskluzivisht për anëtarët e saj.

Seminari kishte për qëllim të ofronte njohuri gjithëpërfshirëse mbi ndryshimet e fundit në kuadrin ligjor të tatimit mbi të ardhurat dhe të ofronte sugjerime për zbatimin efektiv të tij.

Diskutimi u përqëndrua në risitë e ligjit të ri duke vënë theksin jo vetëm në ndryshimet legjislative, por edhe duke vënë në dukje sfidat teknike të hasura gjatë zbatimit të tij. Ekspertët e Komitetit të Taksave kanë punuar shumë me ligjin dhe udhëzimin dhe seminari u fokusua në rritjen e të kuptuarit të anëtarëve dhe lehtësimin e integritit të pandërprerë të këtyre ndryshimeve në operacionet e tyre të biznesit. Seminari siguroi një platformë për angazhim dhe diskutim shumë aktiv.

Neritan Mullaj, Drejtor Ekzekutiv i Dhomës Amerikane, nënvizoi rëndësinë e aktivitetit, duke theksuar domosdoshmërinë për të sqaruar dhe diskutuar ndryshimet në ligjin për tatimin mbi të ardhurat.

“Interesi i lartë për temën e këtij seminari provon se sa nevojë ka të shpjegohen dhe diskutohen ndryshimet që ka pësuar ligji. Ishte qëllimi ynë që të ndihmonte



stafet e kompanive të anëtarësuar të Dhomës Amerikane të kuptojnë drejt disa elementë themelore të ligjit, dhe mendoj se ia arritëm më së miri së bashku” – u shpreh Z. Mullaj.

Përpjekjet e zellshme të ekspertëve të Komitetit të Taksave dhe Doganave u vlerësuan për hartimin e përpiktë të komenteve dhe udhëzimeve mbi ligjin. Duke shfrytëzuar ekspertizën e tyre të lartë, Dhoma Amerikane në mënyrë efektive i ka komunikuar Ministrisë së Financave çështjet përkatëse përmes një letre zyrtare, me qëllim adresimin e shqetësimeve që lindin nga zbatimi i tij. Këto përpjekje synonin të zbusnin subjektivitetin në interpretimin e ligjit, duke lehtësuar kështu zbatimin e tij.



Gjatë seminarit, Kryetarja e Komitetit të Taksave dhe Doganave, Znj. Alketa Uruçi bëri një prezantim gjithëpërfshirës, duke sqaruar aspekte thelbësore që rrjedhin nga ndryshimet legjislative që bizneset t’iu kushtojnë vëmendje. Duke reflektuar mbi përpjekjet e Komitetit, Znj. Uruçi theksoi përkushtimin e tyre për rritjen e praktikitetit dhe efikasitetit të ligjit, duke u shprehur se “si Komitet kemi punuar shumë dhe kemi dhënë komentet tona për ta bërë ligjin jo vetëm më praktik, por edhe më efikas, në përpjekjet për të zvogëluar informalitetin dhe subjektivitetin”.

“Ligji vazhdon të ketë problematika dhe lë shteg për informalitet, pasi parashikon kategorizimin e biznesit në varësi të formës ligjore si dhe përmban përjashtime tatimore për kategori të veçanta që nuk incentivojnë formalizimin e ekonomisë” – u shpreh Znj. Uruçi.

Në seminar morën pjesë më shumë se 120 profesionistë të bizneseve të ndryshme, anëtarë të Dhomës Amerikane të Tregtisë.

“E mira është armiku i madhësisë” – citoi Presidenti i Dhomës Amerikane z. Grant Van Cleve duke përmbledhur në një frazë të vetme nevojën për përmirësime të mëtejshme për t’i ofruar ekonomisë, biznesit dhe vendit më të mirën e mundshme.



KLIMA E BIZNESIT NË QENDËR TË DISKUTIMIT

CEO Forum ul në tryezë drejtuesit e AmCham dhe Ministrin e Financave z. Mete

Ka qënë ky thelbi i diskutimit në Forumin e CEO-ve me Ministrin e Financave z. Ervin Mete më datë 26 Mars 2024, ku drejtues të lartë të Dhomës Amerikane dhe kompanive më të mëdha në vend kanë diskutuar çështjet themelore që shqetësojnë biznesin në aktivitetin e përditshëm duke synuar të gjejnë zgjidhje përmes dialogut dhe bashkëpunimit.

“Erërat po fryjnë në drejtimin tuaj, duke ju sjellë rritje ekonomike, por këto gjëra të mira mund të mos jenë të mjaftueshme për të arritur atje ku duhet. Shqipëria ka potenciale për të zhvilluar në turizëm apo në teknologji inovacioni por ka probleme me fuqinë punëtore të kualifikuar, dhe për këtë duhet të gjendet një zgjidhje”, tha Presidenti i Dhomës Amerikane, z. Grant

Van Cleve.

Duket se të njëjtin opinion ka ndarë edhe Ministri i Financave i cili ka qënë i mendimit se temat e diskutimit me AmCham, janë të rëndësishme pasi përmbledhin çështje me të cilat përballat biznesi në përditshmëri dhe impaktojnë përmirësimin e mëtejshëm të klimës së biznesit dhe shndërrimin e Shqipërisë në një vend edhe më tërheqës për investimet e huaja. Ministri i Financave z. Mete, ka shfrytëzuar takimin me Dhomën Amerikane për të informuar publikun përmes mediave mbi stimujt e pritshëm që do të zbatohet qeveria për të impaktuar punëmarësit.

“Në qershor mund të prezantojmë edhe një mini-paketë me masa lehtësuese sa i përket tatimit. Nisur nga performanca shumë e mirë e të ardhurave

dhe në mënyrë që këtë momentum të mirë që po kalon ekonomia ta përkthejmë në një shpërndarje më të drejtë të mirëqënies për qytetarët”, tha Ministri Mete gjatë Forumit të CEO-ve

Politika fiskale ishte në fokus të Forumit të CEO-ve të Dhomës Amerikane të Tregtisë, dhe Kryetarja e Komitetit të Taksave dhe Doganave, Alketa Uruçi, ka sjellë në vëmendje problemet e vjetra të pazgjidhura siç është informaliteti por dhe çështje të reja si rivitalizimi i Këshillit Tatimor, transparenca dhe qëndrueshmëria e ligjeve,

“Çështja e parë që është ngritur nga anëtarët e Dhomës, prej vitesh, është informaliteti në ekonomi dhe masat që duhet të ndërmerret qeveria për zgjerimin e bazës së tatueshme. As ligji për tatimin mbi të ardhurat nuk i mbylli shtigjet, pasi kemi diferencime për sektorë të ndryshëm, e disa të tjerë janë të përjashtuar deri në vitin 2029, u shpreh Uruçi.

Drejtori Ekzekutiv i Dhomës z. Neritan Mullaj ka theksuar rëndësinë e komunikimit institucional si e vetmja formë e trajtimit të problematikave që has biznesi. “Dita e sotme shënon një mundësi të rëndësishme për dialog in-

stitucional midis Dhomës Amerikane dhe Ministrisë së Financave, duke nxjitur bashkëpunimin për çështje kritike që ndikojnë bizneset në Shqipëri”

Ka qënë i menjëhershëm reagimi i Ministrisë Mete i cili ka deklaruar se për të forcuar më tej komunikimin dhe për të patur një ndërveprim sa më të madh me biznesin, janë në hapat e fundit të konstituimit të Këshillit Tatimor dhe ka ftuar ekspertët e mandatar nga Dhoma Amerikane të bëhen anëtarë. Z. Mete ka qënë i gatshëm për të vijuar takimet me AmCham për të diskutuar në kohë çështjet që kalon biznesi dhe zgjidhjet e propozuara prej tyre.

ÇËSHTJET KRYESORE TË DHOMËS AMERIKANE TË TRAJTUARA NË FORUM

QËNDRUESHMËRIA FISKALE:

Theksohet domosdoshmëria për **politika tatimore të drejta, të qëndrueshme dhe të parashikueshme** për të zbutur efektet e pafavorshme mbi bizneset. Sugjerohet që Ministria e Financave t'i japë përparësi përditësimit të **Udhëzimit për Tatimin mbi të Ardhurat**, duke integruar reagimet e mbledhura nga bizneset që nga fillimi i zbatimit. Për më tepër, duhet bërë një **fushatë gjithëpërfshirëse sensibilizuese** që synon ndërgjegjësimin e biznesit për zbatimin e ligjit të ri për tatimin mbi të ardhurat.

RRITJA E TRANSPARENCËS NDAJ TATIMPAGUESVE:

Theksohet domosdoshmëria për të publikuar të gjitha qëndrimet në lidhje me dispozitat specifike ligjore nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve apo Ministria e Financave. Gjithashtu, u theksua nevojja për rritjen e proceseve të konsultimit dhe komunikimit institucional për të siguruar publikimin në kohë të projekt-akteve dhe reagimet e përgjegjshme ndaj komenteve të biznesit.



EKONOMIA INFORMALE DHE ZGJERIMI I BAZËS SË TATIMPAGUESVE:

Përkrahjet fuqimisht rritja e të ardhurave buxhetore, përmes **integritit të më shumë tatimpaguesve** në ekonominë formale, **pa përdorur rritjen e normës së tatimit**. Hartimi i nje politike kundër informalitetit konsiderohet thelbësor për arritjen e këtij objekti.

NDRYSHIMET LIGJORE NË PROCES:

Eshtë e domosdoshme një analizë rigoroze e projektligjeve të propozuara kohët e fundit që ndikojnë në barrën fiskale, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me **taksën mbi pasurinë e paluajtshme, sigurimin e detyrueshëm ndaj tërmetejeve, projektligji për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit**. Radhiten shqetësimet e ngritura nga bizneset në lidhje me mbivendosjen e taksave dhe përfshirjen e nevojshme

të Ministrisë së Financave.

ÇËSHTJET E SEKTORËVE SPECIFIKË DHE BIZNESET E MËDHENJ:

Disa sektorë dhe biznese të mëdha po përballen me probleme, veçanërisht me **praktikat e rivlerësimit tatimor nga autoritetet tatimore**, për përjashtimet nga TVSH-ja të lëshuara nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, duke tejkaluar afatet ligjore. Ndryshimi i udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Energjisë është thelbësor për shmangien e kësaj problematike. Bizneset janë në pritje të **miratimit të një Udhëzimi të Ri të Ministrisë së Financave** për zbatimin e Marrëveshjeve Tatimore. Vazhdojnë shqetësimet lidhur me vonesat nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) në zbatimin e këtyre marrëveshjeve, me vonesa të vazhdueshme ose përgjigje jo të plota për aplikimet.

RIVITALIZIMI I KËSHILLIT TATIMOR:

Janë shumë të dobishme përfitimet nga riaktivizimi i Këshillit Tatimor për nxitjen e politikave fiskale.

SISTEMET E REJA TË PAGESAVE (ELEKTRONIKE):

Nismat e qeverisë dhe legjislativi përkatës në këtë sferë, së bashku me aplikimin e Shqipërisë për t'u anëtarësuar në Eurozonë (SEPA), u diskutuan gjerësisht.



Anëtarët e AmCham flasin me përfaqësuesin e Korporatës Financiare të Zhvillimit Ndërkombëtar të SHBA,

Potenciali i DFC dhe mundësitë e bashkëpunimit me biznesin në Shqipëri

Dhoma Amerikane ka organizuar në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane një sesion informues mjaft interesant me z.Walter Jones, Drejtorin e Investimeve në Korporatën Financiare të Zhvillimit Ndërkombëtar të SHBA (DFC), për Evropën dhe Euroazinë i cili ka prezantuar për anëtarët e AmCham potencialin që ofron bashkëpunimi me një prej institucioneve financiare më të fuqishme në botë.

Korporata Financiare e Zhvillimit Ndërkombëtar të SHBA (DFC) është institucioni financiar Amerikan i cili ofron mundësi të qëndrueshme financimi për projekte në të gjithë sektorët duke përfshirë energjinë, kujdesin shëndetësor, infrastrukturën kritike dhe teknologjinë. DFC është gjithashtu një mbështetëse financiare për bizneset e vogla dhe gratë sipërmarrëse në mënyrë që të krijojnë vende pune në tregjet në zhvillim duke respektuar parimet themelore të të bërit biznes dhe standardet mjedisore dhe të drejtat e punonjësve.

Detaje më të hollësishme mbi strukturën e DFC-së dhe mënyrën se si operon, i ka sjellë përmes prezantimit z. Jones duke shpjeguar për të gjithë anëtarët e pranishëm në takim, cilat janë format e financimit dhe kriteret që DFC aplikon.

DFC ka potencialin të ofrojë kredi dhe garanci deri në 1 miliard dollarë për periudha kohore deri në 25 vjet, me programe specifike të synuara për biznese të vogla dhe të mesme në Shtetet e Bashkuara. Në instrumentat e saj financiare bëjnë pjesë edhe financimi i borxhit dhe fonde të kapitalit privat për tregjet në zhvillim për të ndihmuar në situatat e mungesës së kapitalit të investimeve.

DFC ndërmerr nisma në Shtetet e Bashkuara dhe vendet e tjera për të

identifikuar partnerë potencialë që mund të përdorin mjetet e financimit të DFC për të arritur dhe zgjeruar biznesin e tyre në tregjet në zhvillim. Takimi me anëtarët e AmCham i shërben pikërisht qëllimit për të njohur biznese potenciale në tregje në zhvillim. Anëtarët e Dhomës Amerikane që përfaqësojnë biznese të mëdha në vend, kanë qënë mjaft të interesuar të bashkëpunojnë me DFC si një mënyrë eficiente e financimit të planeve të tyre zhvillimore dhe diversifikimit të biznesit në projekte që kanë nevojë për kapital investues.

“AmCham mund të jetë koordinator i mirë për të ndërlidhur mundësitë që ofron DFC me nevojat dhe interesat tuaja për të zhvilluar biznesin” – tha gjatë takimit Neritan Mullaj. Takimi ka vazhduar me network-un ku drejtues të AmCham, anëtarë Bordi përfaqësues nga USAID dhe Ambasada Amerikane kanë ndërvepruar me njëri-tjetrin duke shkëmbyer informacion dhe mundësi të bashkëpunimit.



Përfaqësuesit e Dhomës Amerikane takohen me Drejtorin e Doganave Genti Gazheli

Takimi i Presidentit të Dhomës Grant Van Cleve dhe Drejtorit Ekzekutiv Neritan Mullaj me Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave Genti Gazheli është hapi i parë i ndërmarrë në vitin 2024 nga drejtuesit e dy institucioneve për të konsoliduar marrëdhëniet e punës në funksion të shërbimit ndaj biznesit.

Dhoma Amerikane ka një histori të gjatë të takimeve periodike me Drejtorinë e Doganave dhe ka ndërtuar një platformë të drejtpërdrejtë të komunikimit në trajtimin e çështjeve që anëtarët e saj hasin në dogana.

Kjo është reflektuar në vlerësimin pozitiv që anëtarët e Dhomës Amerikane i kanë dhënë marrëdhënieve me doganat në Indeksin e Biznesit duke dëshmuar efektivitetin e ndërtimit të urave të bashkëpunimit mes biznesit dhe institucioneve.


Për të forcuar këtë marrëdhënie, drejtuesit e AmCham dhe Doganave, kanë folur konkretisht për planet e bashkëpunimit gjatë vitit dhe format



më të mira të trajtimit të çështjeve ad hoc apo ato që janë në proces. Doganat kanë një sërë problematikash të ngritura nga anëtarët e AmCham ndërkohë që vijimi lehtësimit të procedurave doganore apo proceset e digjitalizimit të sistemeve, mbeten tema dypalëshe për të cilat është e nevojshme shkëmbimi i informacionit dhe diskutimi mbi zgjidhjet e propozuara.

Drejtuesit e të dy institucioneve e vlerësuan si mjaft të rëndësishëm promovimin e statusit OEA (Operatori Ekonomik i Autorizuar) dhe inkurajimin e biznesit për të aplikuar për këtë status që lehtëson dhe shkurton kohën procedurave në dogana.

Dhoma Amerikane është e vetëdijshme se doganat, janë porta hyrëse e biznesit në tregun vendas dhe për rrjedhojë dhe impresionin e parë që biznesi lokal por dhe investitorët e huaj marrin për standartin e klimës së biznesit në vend. Në funksion të këtij qëllimi Dhoma Amerikane do të vijojë të nxisë këto bashkëpunime dhe marrëdhënie që prodhojnë siguri, qartësi për biznesin.



FLASIN EKSPERTËT E KOMITETIT DIGJITAL

Inteligjenca Artificiale dhe inovacioni si e ardhmja e biznesit, Sfidat në aplikimin e AI

Ekspertët në Komitetin Digjital kanë bërë një analizë të thellë të rezultateve të pyetësorit mbi Inteligjencën Artificiale i organizuar me anëtarët e AmCham.

Pyetësori ka patur interesin e mbi 60 përqind të anëtarëve, përgjigjet e të cilëve kanë ndihmuar Komitetin të kuptojë sa njihet dhe përdoret Inteligjenca Artificiale nga biznesi në vend.

Linda Shomo, Kryetare e Komitetit Digjital duke prezantuar gjetjet e pyetësorit, ka orientuar diskutimin mbi çështjet që dalin nga rezultatet dhe tregojnë sa janë të familjarizuar bizneset e Dhomës Amerikane me format e inteligjencës artificiale, sa i përdorin në biznesin e tyre dhe kualifikimet që kanë stafet përkatëse. Rezultatet e pyetësorit do të jenë guida me të cilën Komiteti do të ndërtojë planin e punës gjatë këtij viti, duke i dhënë peshën e duhur çështjeve që lidhen me trajnimin, me zhvillimet digjitale por dhe organizimin e forumeve ku flitet për inovacionin dhe sfidat e aplikimit duke përfshirë ekspertë lokale dhe ndërkombëtare.

Mbledhja e zhvilluar në ambientet e Shkollës Holberton, i dha mundësinë anëtarëve të Komitetit të ndajnë eksperiencat e tyre në ndërtimin e aplikacioneve inteligjente që po i vijnë në ndihmë biznesit në sektorë të ndryshëm duke revolucionarizuar proceset e punës. Kriimi aplikacioneve dhe zgjidhjeve teknologjike që i ndihmon CEO-të të drejtojnë edhe në distancë biznesin e tyre, po përbën bazën e produktit që ata krijojnë dhe po kërkon gjithnjë e më shumë stafe të kualifikuara. Kjo e lidh ngushtë biznesin me sistemin edukues dhe kurrikulat që duhet të përfshihen në të dhe kjo u theksua edhe gjatë eventit, duke kërkuar më shumë bashkëpunim shkollë – biznes -Ministri Arsimit për të adoptuar njohuritë e reja në kohë reale tek forcat e reja të punës.

“Mendoj se aplikimi i Inteligjencës Artificiale është një diskutim global dhe Dhoma Amerikane ka potencialin ta orientojë këtë diskutim në komu-

nitetin e biznesit dhe t’i ndihmojë të niohin të rejtat e fundit dhe avantazhet e përdorimit” – u shpreh Linda Shomo gjatë takimit.

Anëtarët kanë folur edhe për “efektet anësore” të përdorimit të Inteligjencës Artificiale, rrisqet që ajo mbart, rrezikun e përdorimit të pajisjeve dhe programeve të pacertifikuara, sulmeve kibernetike dhe mënyrën si duhet të trajnohen bizneset për të qënë të sigurtë.

Drejtori i AmCham Albania Neritan Mullaj ka kërkuar nga Komiteti të draftojë një listë prioritare çështjesh që duhen trajtuar gjatë vitit për ti përfshirë në kalendarin e eventeve. Pjesë e këtij kalendari do të jetë jo vetëm trajnimet për sulmet kibernetike dhe format e përdorimit të Inteligjencës Artificiale, por dhe procese lobuese që synojnë ngritjen e kuadrit ligjor në përputhje me atë të BE-së dhe rregullimin e veprimtarisë së sektorit.

Një tjetër element interesant i punës së këtij Komiteti gjatë 2024 do të jetë edhe puna me institucionet e krijuara së fundi si Agjencia e Inovacionit dhe angazhimet në Forume Ndërkombëtare ku flitet për teknologjinë dhe inovacionin.



Zbatimi i Ligjit të Tatimit për të Ardhurat, çfarë duhet të dinë bizneset

Ligji i Tatimit për të ardhurat dhe aktet udhëzuese të tij, kanë filluar nga zbatimi më 1 janar 2014 duke sjellë ndryshime të rëndësishme për biznesin. Dhoma Amerikane, përmes Komitetit të Taksave dhe Doganave me qëllimin që t'i vijë në ndihmë anëtarëve, ka filluar një fushatë të informimit dhe diskutimit të të gjitha çështjeve që janë shfaqur gjatë zbatimit dhe kërkojnë vëmendjen e ekspertëve por dhe të administratës tatimore.

Mbledhja e fundit e Komitetit ka shërbyer për të shkëmbyer informacion në nivel ekspertësh mbi çështjet dhe shqetësimet që janë shfaqur në zbatimin konkret të ligjit dhe akteve udhëzuese, dhe mënyrën më të mirë për t'i adresuar ato dhe për të informuar në të njëjtën kohë anëtarët.

Komiteti do të organizohet në vijim për të zhvilluar një dialog me Ministrinë e Financave dhe për të organizuar një event të përbashkët ku ekspertët e kësaj Ministrie do të japin më shumë informacion mbi disa paqartësi në zbatimin praktik të ligjit dhe mënyrën se si bizneset duhet ti kuptojnë dhe zbatojnë ndryshimet në ligji.



Komiteti Ligjor dhe Rregullator vijon punën mbi çështje aktuale të anëtarëve

Komiteti Ligjor, Rregullator dhe IPR ka organizuar takimin e rradhës për të diskutuar mbi çështjet ligjore dhe rregullatore të ngutshme si dhe të sjella në vëmendje nga anëtarët e Dhomës. Kryetarja e Komitetit ka ndarë zhvillimet lidhur me prioritetet e Komitetit për këtë vit, duke vendosur fokusin mbi planin e mëtejshëm të punës dhe pjesëmarrjes në aktivitete. Gjatë mbledhjes, anëtarët e parapërgatitur në çështje të caktuara sipas fushës së tyre të ekspertizës kanë kontribuar me qasjet profesionale dhe hulumtimet respektive.

Tematikat e diskutuara mbuluan ndër të tjera, të dhënat personale dhe regjistrat publikë, pronësia intelektuale edhe në kuadër të tregut të përbashkët, organizimet e mëtejshme mbi konkurrencën dhe zhvillimet e mundshme mbi raportimet e përgjegjësive së biznesit në kuadër të ESG.



Krijohet grupi punës së sektorit shëndetësor në AmCham, fokusi në adresimin e çështjeve sektoriale të biznesit

Sistemi shëndetësor dhe çështjet që përcjell për biznesin që operon në këtë sektor në degën e farmaceutikës, shërbimit spitalor, pajisjeve mjekësore etj, kanë mbledhur bashkë një grup pune në AmCham, fokusi i të cilit do të jetë diagnostikimi dhe ndjekja e problemeve që ka sektori.



Presidenti Grant Van Cleve dhe Drejtori Ekzekutiv Neritan Mullaj kanë ofruar mbështetjen që mund të japë Dhoma Amerikane përmes eksperiencës më të mirë të punës lobuese të strukturuar në Komitete duke ofruar ekspertizë dhe logjistikë për çështjet e biznesit. Grupi i punës do të jetë hapi i parë për të organizuar këtë pjesë të biznesit në sektorin e shëndetësisë që përballlet me sfida dhe çështje të ndryshme dhe kanë nevojë të analizojnë në mënyrë zyrtare problemet e tyre.

Përfaqësues të njohur të kompanive farmaceutike dhe kujdesi shëndetësor kanë folur për çështje makro që kalon sektori duke vendosur theksin në reformimin e sistemeve rregullatore dhe zhvillimin e politikave që e ndihmojnë sektorin të zhvillohet dhe pacientët të marrin shërbim më të mirë shëndetësor. E parë në këtë këndvështrim përfaqësuesit e biznesit ishin të mendimit se rritja e buxhetit do të ndihmonte në investimin jo vetëm në infrastruktura por dhe në indikatorët e tjerë që duhet të ofrojë shërbimi shëndetësor.

Statistikat e prezantuara nga

kompania IQVIA sollën të dhëna nga Shqipëria dhe rajoni dhe forma krahasuese mes tyre mbi nivelin e shpenzimeve për banorë në sektorin e shëndetësisë në përdorimin e medikamenteve, kurave individuale dhe pajisjeve mjekësore në vend.

Grupi punës ka dakortësuar të organizohet përmes ekspertëve të fushës në draftimin e një strategjie pune për të adresuar në institucionet shtetërore përkatëse problematikat që has biznesi dhe për të propozuar zgjidhje konkrete që mund të arrihen vetëm përmes dialogut konstant. Ata kanë shprehur besimin në potencialin avokues të AmCham dhe në format profesionale të dialogut dhe lobimit që ofron dhe që e bëjnë rezultative këtë proces



Universiteti Epoka jep çmime për më të mirët e TUNG IDEVE

TUNG IDEVE ka mbledhur të rinjtë e talentuar nga shkollat e mesme në një konkurrim të ideve inovatore të organizuar nga Klubi i Studentëve Inovatorë në Universitetin EPOKA të drejtuar nga këshilltarja e tyre dhe dekanja e fakultetit Assoc. Prof. Dr. Alba Kruja, së bashku me Universitetin e Potsdamit.

Rreth 53 nxënës të shkollave të mesme, të organizuar në 12 grupe, duke shfaqur aftësitë e tyre inovative dhe sipërmarrëse dhe janë gjykuar nga një juri profesionistësh mes të cilëve dhe Presidenti i AmCham Albania Grant Van Cleve dhe Drejtori Ekzekutiv Neritan Mulla. Pjesë e jurisë kanë qënë Kryetarja Diana Leka Sekretare e Përgjithshme nga Këshilli Shqiptar i Investimeve dhe emra të spikatur në organizatat e biznesit Z. Bledar Mankollari, Drejtor Menaxhues nga Shoqata Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri,

z. Samir Shqarri, President dhe Drejtor Ekzekutiv i Dhomës së Tregtisë së Shqipërisë në Zvicër si edhe Dr. Aida Lahi, Këshilltare e Lartë Politike nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës.

Paneli i jurisë ka vlerësuar me çmime tre grupe nxënësish të cilët u shpërblyen me bursa për performancën e tyre të jashtëzakonshme. Ekipet fituese ishin nxënësit e Kristaq Rama me projektin e tyre "Buzzy Bees", duke marrë një bursë 75% si fitues të vendit të parë, nxënësit e Sami Frasheri me grupin "M.E. G", duke siguruar një bursë 50% si fitues të vendit të dytë; dhe nxënësit e Medreseja e Tiranës

me "BioPesticide" si fitues të vendit të tretë, duke fituar një bursë prej 25%.

Drejtuesit e Dhomës Amerikane janë impresionuar nga idetë inovatore dhe talenti i të rinjve çfarë tregon se një bashkëpunim më i madh i biznesit me sistemet universitare dhe shkollat e mesme do të ndihmojë për të kanalizuar qartë potencialin e të rinjve dhe të orientojë talentin e tyre.

Konkursi Dimëror TUNG IDEVE i organizuar nga Universiteti Epoka është një model i mirë për t'u ndjekur në angazhimin e të rinjve dhe besimin që j'u jepet se idetë e tyre janë start up-e të jashtëzakonshme biznesi. Këtë janë munduar të përcjellin përmes vlerësimit të tyre edhe drejtuesit e Dhomës Amerikane duke besuar se networku i kompanive anëtare të AmCham dhe ekspertiza që kanë mund të bëhen koordinatorët më të mirë mes shkollave dhe universiteteve për të përputhur idetë novatore me interesat e biznesit.

Organizohet kompeticioni “Young Innovators”, në kuadër të përmbylljes së lëndës së Inovacionit

Drejtori Ekzekutiv i AmCham Albania, Neritan Mullaj ishte pjesë e kompeticionit “Young Innovators 2024”, në kuadër të përmbylljes së lëndës së inovacionit në Fakultetin Ekonomik. Aktiviteti me një traditë disavjeçare, gëzon mbështetjen e veçantë të Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë, Prof. Dr. Dhori Kule zhvilloi këtë vit 120 ide fillestare nga studentë të Administrim Biznesit dhe Informatikës Ekonomike, ku 13 prej tyre u përzgjedhën për në finale.

Të pranishëm në këtë kompeticion ishin mbi 300 studentë, Zëvendës Rektori i Universitetit të Tiranës, Prof. Asoc. Dr. Bernard Dosti, Përgjegjëse e Departamentit të Manaxhimit dhe pedagogë të Departamentit të Menaxhimit, si dhe përfaqësues të bizneseve



të mëdha në vend.

Eventi u hap nga Dr. Nertila Busho, lektore e lëndës së Inovacionit, e cila shprehu falenderimet e vecanta për të gjithë aktorët dhe mbështetësit e këtij aktiviteti.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Prof. Asoc. Dr. Bernard Dosti shprehu rëndësinë e startup-eve për zhvillimin

e tregut të punës dhe ekonominë e vendit, duke cilësuar rolin e rëndësishëm që ka Fakulteti i Ekonomisë në zhvillimin e nxitjes e sipërmarrjeve të reja. Gjithashtu, Z. Neritan Mullaj vuri theksin tek zhvillimi i ideve inovatore për zhvillimin e sektorit privat, duke ofruar mbështetje të plotë institucionale për Fakultetin e Ekonomisë dhe studentët.



Dita e Karrierës në Shkollën e Mesme të “New York”-ut

Drejtori Ekzekutiv i Dhomës Amerikane ishte i ftuar si mentor nga drejtuesit e shkollës së mesme të New York në ditën e “Këshillimit të Karrierës”.

Gjeneratat e reja po formohen në kushtet e zhvillimeve të forta teknologjike, duke e bërë akoma më sfiduese dhe një përgjegjësi të madhe mënyrën se si udhëhiqen dhe dijet që i përcjellin. Z. Mullaj përcolli përmes fjalës së tij, një informacion të detajuar për zhvillimet në një organizatë biznesi, roli që luan në tregun e punës dhe këshillat për një të ardhme, ku nxënësit mund

të jenë në rolin e sipërmarrësit apo të punëmarrësit. Ishin të shumta pyetjet mbi mënyrat se si materializohen idetë në një biznes duke demonstruar interesin e nxënësve.

Drejtori Ekzekutiv i AmCham, z. Mullaj, ka vlerësuar nismat sipërmarrëse në një moshë kaq të re, me risi të denja për start-up, por mbi të gjitha me entuziazmin e tyre për t'i bërë ato realitet. Ai e ka konsideruar si një detyrë e biznesit dhe stafeve pedagogjike, për të zhvilluar mirë këtë brez, duke kontribuar dhe mbështetur me njohuri dhe vetëbesim.

Siguria dhe Roli Kryesor i Sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (ICT) në Britjen Ekonomike

Grant Van Cleve
Prodigy Shpk
President i AmCham
Albania

Përgjatë rolit tim në AmCham, edhe në nivel lokal njihem për një sërë rolësh që luaj në ekosistemet e teknologjisë dhe inovacionit. Investoj në startupe. Kam bashkëthemeluar shkolla trajnimit teknologjik. Kam dhënë këshilla për pjesë të qeverisë për politikën e inovacionit. Kjo mund të konsiderohet si një lloj emigracioni i dukshëm nga sektori i zhvillimit të pronave të patundshme në Shqipëri ku isha i përfshirë në vitet 2000. Dhe është një ndryshim i befasishtëm duke marrë parasysh se nuk jam një teknolog.

Por pata privilegjin të kaloj vite në Kaliforni, SHBA, gjatë viteve 2010, duke mësuar për ndikimin eksploziv ekonomik që teknologjia shkakton në nxitjen e transformimeve në industri. U thellova më shumë dhe përfundova duke pasur një dekadë fantastike si investitor dhe sipërmarrës në këtë fushë.

Me gëzoi fakti në 2021 se Shqipëria po pranonte teknologjinë dhe inovacionin si shtylla kyçe të zhvillimit ekonomik. Tashmë, kam më shumë se gjysmën e viteve të mia në Shqipëri duke mbështetur këtë transformim. Dhe me shpresë, duke përfituar prej tij gjithashtu.

"DYFISHIN OSE ASGJË"

Për të kuptuar pse teknologjia dhe inovacioni janë bërë një prioritet i tillë në Shqipëri, le të referohemi një artikulli të anëtarit të AmCham, Admir Malaj, që sugjeron që të përqendrohemi në krijimin e 100 mijë programuesve në



Me gëzim të madh, mësova në 2021 se **Shqipëria po pranonte teknologjinë dhe inovacionin si shtylla kyçe të zhvillimit ekonomik.** Tani, po kalohet më shumë se gjysma e viteve të mia në Shqipëri duke mbështetur këtë transformim.

Shqipëri. Ai përshkruan këtë moment si një kryqëzim të madh. Ne mund të bëhemi një vend, të rinjtë e talentuar të të cilit kanë shkëputur lidhjen me të, duke lënë pas një popullsi të plakur që jeton nga dërgesat e emigranteve dhe disa ndarje pasurie që rrjedhin nga turizmi ku punësohen të huaj... ose ne mund të shkojmë qëllimisht drejt

punëve dixhitale që ofrojnë paga të larta dhe detyra të rëndësishme ku jetohet mirë, me dinjitet. Mbi bazën e kësaj vale programuesish të kualifikuar, ndërtojmë rrugën – dhe marim përsipër - një komb që përfiton të ardhura të larta për frymë, një set shërbimesh dhe përfitimesh të kënaqshme.

Dhe kjo "ëndërr" nuk kërkon tërheqjen e miliardave në kapital për të ndërtuar fabrika gigante. Nuk kërkon prekjën e burimeve natyrore. Ajo mund të fillojë përmes kurseve moderne të përmirësimit që i përgatisin njerëzit për punë globale në teknologji. Ne gjithashtu mund të rishikojmë sistemin tonë arsimor (vendosur programe në kurrikula, ringjalljen e Arsimimit Profesional me fokus të shtuar në aftësitë më të larta teknologjike), duke siguruar një rrjedhë të vazhdueshme të kapitalit njerëzor.

SHUMËFISHUESI I INOVACIONIT.

Pjesa e sekretit për këtë është se 'një punë nuk është vetëm një punë.' Disa janë më të fuqishme sesa të tjera. Dhe disa vende ushqejnë punë të tilla katalitike më shumë se të tjerat. Enrico Moretti, një italian që jep mësim në Berkeley në SHBA, shkruan në librin "Gjeografia e Re e Punës", se "vendndodhjet magnetike kanë ekologji pozitive që shumëfishojnë inovacionin, kreativitetin dhe pasurinë. Vendndodhjet e braktitura kanë ekologji negative dhe bien edhe më shumë." Libri i Moretti sugjeron se, në qytetet magnetike të tilla, për çdo vend pune shtesë në një firmë mesatare të teknologjisë së lartë, krijohen pesë vende pune shtesë jashtë saj për komunitetin lokal. Disa vende, si Silicon Valley, arrijnë deri në 7, ndërsa një vend si Italia përpëlitet të arrijë në 4. Por edhe atje impakti është i dukshëm.



Në lidhje me këtë, studimet e fundit tregojnë se investimet e "engjëllit të biznesit" në startup-et teknologjike kanë një efekt shumëfishues të ngjashëm. Çdo \$100,000 të investuar gjenerojnë 5.8 vende punë drejtpërdrejt, \$458,000 në pagesa, \$2,100,000 në prodhim ekonomik dhe \$37,000 në të ardhura shtetërore dhe lokale. Arritja e këtyre rezultateve duhet të jetë një prioritet në politikën publike dhe objektivat e biznesit. Qeveria lokale (dhe ajo kombëtare gjithashtu) mund të ndjehen komod të mbështeten në kërkime të tilla dhe të dedikojnë burime (përfshirë ndërtesa) pikërisht për shkak të 'efektit shumëfishues' që vjen nga punët e inovacionit dhe teknologjisë. Ne ndihmojmë ekonominë në përgjithësi, duke përfshirë sektorët e shërbimeve me vlera të ulta pagesash punët në sektorët e prodhimit, si dhe rrisim të ardhurat publike përmes promovimit në ICT dhe startup-et teknologjike. Bashkimi Evropian po përpiqet të shmangë zgjedhjen e sektorëve përfitues duke bërë presion mbi vendet candidate për të eliminuar dallimet në trajtimin tatimor midis sektoreve. Si një Dhomë Amerikane, mund të ndjehemi të sigurt se ka avantazhe ekonomike dhe sociale të dallueshme që vijnë nga prioritetizimi i këtij sektori të rëndësishëm.

"RRJEDHJA E TRURIT" VS "TËRHEQJES SË TRURIT"

Në mënyrë të qartë, shpresa është që një popullsi e trajnuar dhe një sektor TIK i zhvilluar do të çojë në më pak njerëz që largohen nga Shqipëria duke kërkuar për toka të gjelbëra diku tjetër. Kjo mund të luajë një rol të vërtetë në ndalimin e çpopullimit të rrezikshëm - "Rrjedhja e trurit" që shqetëson Shqipërinë. Por edhe më shumë, kjo mund të rezultojë në "tërheqjen e trurit". Një pjesë e mirë e diasporës shqiptare është e angazhuar në mënyrë të kuptueshme në sektorët e teknologjisë dhe inovacionit, dhe një pjesë e tyre mund të kthehen dhe të ndihmojnë në zhvillimin e kësaj rruge. Ne gjithashtu mund të përfitojmë nga të huajt me aftësi të forta (dhe pagat) që zgjedhin të jetojnë në vendin tonë vibrues për arsye personale. Fenomeni i punës në distancë ka ndërlidhur vendndodhjen me punët në një mënyrë tërheqëse. Dhe kombinimi i kushteve atmosferike të Shqipërisë, veçorive natyrore dhe një popullsie mikëpritëse shumëgjuhëshme e ka bërë Shqipërinë një vend përfitues surprizë prej mi-

Në mënyrë të qartë, shpresa është që një popullsi e trajnuar dhe një sektor TIK i zhvilluar do të çojë në më pak njerëz që largohen nga Shqipëria duke kërkuar për toka të gjelbëra diku tjetër.

grimit të punës. Njerëzit që mund të bëjnë punën e tyre nga kudo tërhiqen nga koeficienti i lartë i 'jetueshmërisë' në Shqipëri. Vendi përfiton nga shpenzimet e tyre dhe kontributet e tatimit të TVSH-së. Ndërsa duke kryer një polinizimin me ta, duke punuar krahas krahit për krahit me ta, do të zgjerohet qasjen tonë në aftësitë kyçe teknologjike dhe përvojat e start-up-eve. Ky grup përfshin nomadët e rinj digjital. Por kategoria e punës në distancë është më e gjerë se kaq. Janë familjet që zhvendosen. Janë zyrtarë qëndrorë që do të kenë ekzekutivët e tyre që mund të jenë kudo por kanë tendencë të vendosen atje ku ka 'jetueshmëri'.

QEVERIA SI UDHEHEQËS, JO I NGATHËT

Qeveria ka treguar një ndërgjegjësim të thellë mbi të gjitha këto dhe ka vendosur prioritete. Ajo ka ngritur Ministrinë e Sipërmarrjes, e cila në kohët e fundit ka zgjeruar mandatin e saj për të përfshirë ndërtimin e një klime të favorshme të biznesit, së bashku me themelimin e një dege Startup Albania. Po ashtu, janë alokuar fonde të dedikuara për të investuar drejtpërdrejt në startup-e. Duke njohur rëndësinë e avancimit të talenteve, Ministria e Rinisë dhe Fëmijëve ka nisur programe bursash për studentët e regjistruar në kurset kryesore të trajnimit teknik. Po ashtu, inovacioni qeveritar është integruar në portofolin e Ministrisë së Ekonomisë nën MEKI-n e krijuar së fundi. Bashkia e Tiranës ka caktuar zonën TEDA për të forcuar më tej inovacionin dhe sipërmarrjen. Më tej, Ministria e Qeverisjes Lokale ka zgjeruar iniciativat nga koha kur shërbente si Nënkyetar Bashkie në Tiranë në një shkallë kombëtare më të gjerë. Miratimet ligjore nga Këshilli i Ministrave për Te-

knoparket kanë çuar në lancimin e fundit të Duranës, me konsiderata për legjislacionin e "Croëdfunding" për të lehtësuar investimet në startup-e. Kryeministri dhe Kryebashkiaku i Tiranës janë të bindur në thirrjet e tyre të vazhdueshme për këto iniciativa.

Pavarësisht orientimeve politike, është e qartë se janë bërë hapa të konsiderueshëm në fushën e teknologjisë dhe inovacionit, çfarë mund të ofrojë përfitime për të gjithë ne. Duke njohur përpjekjet të vlerësuara të enteve qeveritare dhe institucionale si BE-ja për Inovacionin dhe AADF, është e rëndësishme të njohim se realizimi i këtyre iniciativave varet rëndësisht nga angazhimi proaktiv i sektorit privat. A jemi duke modernizuar produktet dhe shërbimet tona? A jemi duke përmirësuar aftësitë e personelit tonë? A jemi duke përhapur një kulturë të sipërmarrjes brenda organizatave tona për të kultivuar përpjekjet inovative? A bashkëpunojmë me ente të jashtme të afta të drejtojnë strategji transformuese?

Në kapacitetin tim personal, jam aktivisht i përfshirë në iniciativat e trajnimit të teknologjisë përmes bashkthemelimit të Shkollës Digjitalë dhe Holberton në Tiranë. Po ashtu, kontribuoj në investime angelike përmes Keiretsu Forum SouthEast Europe dhe mbaj aksione në kompani teknologjike si Alphatechs. Po ashtu, jam i përkushtuar të jap më tej duke trajnuar startup-e, duke ofruar shërbime këshillimore qeverisë në çështje ligjore dhe duke marrë pjesë në konkurse prezantimesh, etj.

Kjo mund të tingëllojë si shumë, por unë e shoh si vetëm fillimin e një udhëtimi transformues. Unë pres që të zhvillohen më shumë mundësi investimi. Më shumë mënyra për t'i hapur rrugën këtij revolucionit përmes infrastrukturës teknologjike. Dhe më pas më shumë mundësi për të promovuar më gjerësisht historinë e Shqipërisë, gjë që duhet të çojë në rritjen e IHD-ve nga kompanitë e teknologjisë. Shpresoj se do të bashkoheni me mua në kërkimin e më shumë mënyrave për t'u bashkuar me këtë prirej emocionuese.

**Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në këtë artikull janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën ose qëndrimin zyrtar të Dhomës Amerikane*

NDRYSHIMI I KONCEPTIT EDUKUES PËR TEKNOLOGJINË NË SHQIPËRI

Admir Malaj
Beta Plan

“Rrota nuk duhet shpikur” është shprehja më e rrezikshme që mund të mbysë që në djep inovacionin. Në fakt rrota është dhe ka mbetur ajo që është, e rrumbullakët, por nga ana tjetër, rrota nuk mund të jetë e njëjtë për çdo terren, prandaj dhe ajo duhet shpikur dhe rishpikur.

Pikërisht për këtë arsye, ne (betaPlan Coding Bootcamps) mbështetemi nga një partner Amerikan, Coding Dojo, për të ofruar disa nga kurset më të mira në Botë në programim dhe punojmë çdo ditë me ta për t'i kontekstualizuar këto kurse për nevojat tona në Shqipëri dhe Rajon, pasi mandati jonë shtrihet në të gjithë Ballkanin Perëndimor.

Tregu i edukimit në teknologji mbetet i vështirë në Shqipëri kryesisht për pesë arsye: (i) Nuk ekziston kultura e pagesës për të mësuar; (ii) ka inflacion të certifikimeve dhe titujve; (iii) biznesi ende nuk i sheh institucionet e edukimit si partnerë të të njëjtit nivel; (iv) tregu është i deformuar nga donatorët; (v) ka stepje për të përqaftuar zgjidhje perëndimore dhe një komoditet me zgjidhjet që vinë nga Lindja.

Për të gjitha këto arsye, formatet perëndimore, e sidomos ato që vinë si partneritete Amerikane nuk ab-



“Ne patjetër kemi interes të përqafojmë inovacionin dhe për më shumë, si anëtarë të AmCham pritet që të kemi dhe prirjen e përqaftimit të inovacionit që lidhet me ShBA”

sorbohen ende në mënyrë natyrale nga tregu. Duket si çudi për shumë persona që në një kurs programimi mund të mos certifikohesh nëse nuk ndjek rregullisht leksionet, apo nuk kalon provat, apo që të refuzohet regjistrimi për arsye objektive. E vetmja pengesë e perceptueshme

është aftësia për të paguar kursin, e cila duhet të sjellë më pas certifikimin gati automatik. Kjo qasje fatkeqësisht shihet shpesh në vendin tonë.

Duhet pranuar që donatorët kanë shtrembëruar tregun me ndërhyrje që kanë krijuar në shumë raste monopole të pjesshme ose të plota, si dhe inflacionim të certifikimit, pra numra pa vlerë reale. Në shumicën e rasteve donatorët, por dhe vetë bizneset ndjehen më komodë të bashkëpunojnë me operatorë nga Evropa Lindore dhe kjo nuk lidhet shumë me kostot, se sa me faktorë të tjerë që vështirë mund të përcaktohen nga logjika e drejtë e punës.

Fatkeqësisht këto mangësi reflektohen edhe nga anëtarësia e Dhomës tonë. Ne patjetër kemi interes të përqafojmë inovacionin dhe për më shumë, si anëtarë të AmCham pritet që të kemi dhe prirjen e përqaftimit të inovacionit që lidhet me ShBA. Duke qenë anëtarë, nuk jemi në Dhomë vetëm për të mbajtur ato lidhje që kemi aktualisht, por për të krijuar dhe fuqizuar të tjera akoma, gjithnjë e më shumë. Fusha e edukimit ofron një mundësi të mirë për të arritur këtë qëllim. Në AmCham jemi tashmë disa kompani që ofrojmë edukim në teknologji në partneritet me akademi



programimi Amerikane. Por, përtej fjalëve të mira, bashkëpunimi konkret dhe në terma ekonomikë me anëtarë të tjerë të AmCham ka qenë gati e pamundur. E kundërta ndodh me dhomat e tjera, si ato Italiane, Gjermane apo Franceze, ku bashkëpunimi i brendshëm shprehet dhe në kontrata tregtare dhe bashkëpunim ekonomik mes anëtarëve.

Ndërkohë, në rajon fryn komplet një erë tjetër, ku kompanitë që bashkëpunojnë apo kanë partneritete me ShBA kërkojnë vazhdimisht zgjerimin e tyre dhe rrjetëzimin me biznese që kanë të njëjtën qasje. Nuk është rastësi që kontrata e parë e suksesshme ka qenë me një nga kompanitë më innovative në Kosovë.

Nuk është vetëm edukimi që has pengesa, tregu shqiptar është një nga të fundit e rajonit që është hapur ndaj ekosistemit Evropian e Amerikan te inovacionit dhe sektorit teknologjik. Vende e tjera të rajonit janë tashmë shumë të përfshira në tregun Evropian dhe Amerikan të zhvillimit softuare, lojrave teknologjike, inteligjencës artificiale, shërbimeve financiare teknologjike. Sot Rumania, Bullgaria dhe Kroacia kanë njëbrirëshin e tyre. (Njëbrirësh zakonisht emërtohet një kompani teknologjike e cila ka arritur një vlerësim prej 1 bilion Dollarë, siç është rasti i One Equity

"Në rajon fryn komplet një erë tjetër, ku kompanitë që bashkëpunojnë apo kanë partneritete me ShBA kërkojnë vazhdimisht zgjerimin e tyre dhe rrjetëzimin me biznese që kanë të njëjtën qasje"

Partners, Payhawk, UiPath). Ndërkohë që në Serbi apo Kosovë kemi shembuj si Frame apo Gjirafa që kanë mbledhur me dhjetëra miliona dollarë investime nga fonde Amerikane apo Evropiane.

Zakonisht njëbrirëshit merren si shembull objektiv i një ekosistemi të suksesshëm, por nuk duhet harruar që një ekosistem janë të rëndësishme dhe zebat, kompani teknologjike që ndoshta nuk arrijnë vlerësimin magjik prej 1 Bln USD, por që janë të suksesshme për të sjellë inovacion dhe që arrijnë që të gje-

jnë kapitale në mënyrë alternative, ose rriten në mënyrë organike. Edhe këtu mund të themi që vende si Serbia apo Maqedonia e Veriut janë më përpara nesh.

Gjithsesi, kjo vonesë nuk duhet parë si një problem i pakapërcyeshëm, por si një rrjedhojë historike e ekspozimit me vonesë të tregut tonë me tregjet e huaja. Nuk duhet harruar që ekosistemi i teknologjisë dhe talenti në vende të tjera të rajonit është një trashëgimi e para 90'. Ekosistemi Shqiptar ka rritur ndjeshëm vitalitetin përgjatë tranzicionit. Tani jemi duke parë frytet e para, duke filluar nga një apo dy start-upe të suksesshme, disa kompani të mëdha që punojnë outsourcing, apo dhe disa kompani të tjera të mëdha që ofrojnë shërbime për institucionet publike ose në mbështetje të bizneseve vendase, e duke vazhduar tek talenti individual i programuesve tanë. E ardhmja duket e ndritur, nëse përballemi me kurajo me pengesat që shpesh ja vendosim vetë vetes, apo na i vendosin miqtë tanë si pasojë e mungesë së besimit e kurajos. Pra, le të guxojmë!

**Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në këtë artikull janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën ose qëndrimin zyrtar të Dhomës Amerikane*

BANKINGU I HAPUR NË SHQIPËRI.

Çfarë ndodhi pas afatit të 30 qershorit?

Linda Shomo

Easy Pay
Kryetare e Komitetit të
Biznesit Digjital



Rajoni i Ballkanit Perëndimor, i përbërë nga vende si Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, ka përjetuar një interes në rritje për zgjidhjet Fintech, për shkak të potencialit të tyre për të adresuar sfidat e përfshirjes financiare dhe për të nxitur rritjen ekonomike. Veçanërisht në Shqipëri, kompanitë Fin-Tech po bëjnë hapa të mëdha, duke e çuar numrin e institucioneve të parasë elektronike të licensuara nga Banka e Shqipërisë në 10. Ky zhvillim nuk ndodhi rastësisht, por si rezultat i një sërë faktorësh, përfshirë: ndryshimet rregullative; rritjen e përdorimit të teknologjisë; nevojën për zgjidhje inovative në fushën e pagesave dhe shërbimeve financiare; dhe, padyshim edukimin financiar.

Në të njëjtën kohë, duke u përballur me këtë sfidë të re, bankat tradicionale po përdorin gjithnjë e më shumë teknologjinë për të përmirësuar përvojën e klientëve të tyre dhe për të krijuar shërbime të reja dhe më të avancuara. Ata kanë zhvilluar aplikacione mobile, platforma online dhe shërbime të tjera digjitale për të lehtësuar transaksionet e tyre dhe për të ofruar zgjidhje inovative për klientët. Tregu bankar në Shqipëri është një nga komponentët kryesor të sistemit financiar të vendit, duke luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe përfshirjen

financiare të popullsisë në vend. Pas një periudhe tranzicioni sfidash dhe transformimesh, më në fund tregu bankar shqiptar po përjeton disa ndryshime të rëndësishme.

ÇFARË ËSHTË BANKINGU I HAPUR?

Bankingu i hapur është një mënyrë e thjeshtë dhe e sigurt për të ndihmuar qytetarët të transferojnë dhe të manaxhojnë më mirë paratë e tyre në banka, pse jo të fitojnë dhe më shumë para.

Kursime apo investime, buxhetim apo dhurim, kredi apo pagesa, Bankingu i Hapur mundëson mënyra të reja për konsumatorët dhe bizneset për të aksesuar një gamë të gjerë dhe me inovative shërbimesh financiare – të gjitha të ndërtaura në sisteme të sigurta nga ofruesit e rregulluar/licensuar.

CILAT JANE PËRFITIMET E BANKINGUT TË HAPUR?

- Qasje në një gamë më të gjerë shërbimesh financiare.
- Përvojë bankingu më e mirë dhe e personalizuar.

- Rritja e kontrollit dhe sigurisë së të dhënave financiare.
- Nxitja e inovacionit dhe konkurrencës në industrinë bankare&fintechs.
- Manaxhimi më i mirë i llogarisë.
- Manaxhimi më i mirë i buxhetit dhe analiza financiare për biznesin.
- Pagesat dhe transfertat më të thjeshta dhe të shpejta.

EasyPay, si një institucion financiar jo bankë, licensuar nga Banka e Shqipërisë që në vitin 2010, momentalisht po mban lidhshirësi-in e testimet të procesit të Bankingut të Hapur me bankat e nivelit të dytë në Shqipëri. Në këtë mënyrë

Easypay po forcon bashkëpunimin e saj me bankat, duke ndjekur kështu trendet globale të marrëdhënieve mes bankave dhe kompanive fintechs.

SFIDAT AKTUALE TË BANKINGUT TË HAPUR NË SHQIPËRI DHE ÇFARE NDODHI ME AFATIN E 30 QERSHORIT?

Së fundmi, edhe Shqipëria, si shumë vende të tjera të Ballkanit Perëndimor, ndodhet në një udhëkryq për sa i përket inovacionit financiar, pasi vitet e fundit është duke u përballur me një rrugëtim sa premtues aq edhe sfidues të Bankingut të Hapur. Në tregun shqiptar, miratimi i ligjit Nr. 55/2020 "Për shërbimet e pagesave", hyrë në fuqi më 02/01/2021, ishte një hap i rëndësishëm për përmirësimin e përdorimit të pagesave elektronike dhe për përfundimin e Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël (2018-2023), e cila fokusohet në përfshirjen financiare dhe përdorimin e pagesave elektronike. Ky ligj është

përshtatur me Direktivën II të Pagesave të Bashkimit Europian, PSD2, për "Bankingun e hapur", duke krijuar hapësirën për një konkurrencë më të madhe dhe një zhvillim më të thellë të sektorit FinTech, dhe pritej të ndodhte më 30 qershor 2024 sipas afateve ligjore në fuqi që fatkeqsisht nuk u arritën në kohë.

Mirëpo, megjithëse duket shumë premtuese, kjo rrugë për institucionet shqiptare financiare bankare dhe për ofruesit e shërbimeve financiare të pagesave, ka hasur dhe pengesa, të cilat kërkojnë patjetër shumë punë e bashkëpunim strategjik mes të gjithë aktorëve të këtij ekosistemi.

Për të mundësuar Bankingun e Hapur, institucionet financiare duhet të ndërtojnë komunikime të sigurt midis sistemeve të tyre, bazuar në rregulloret teknike të Autoriteteve. Vetëm në shkurt të vitit 2024, u publikua API e parë nga tregu bankar, të cilat mundësonin fillimin e procesit të integritimit të sistemeve të institucioneve të Pagesave dhe testimin të komunikimit midis tyre dhe ndërkohe ka akoma banka që nuk kanë publikuar API-n (ndërfaqen) e tyre për të bërë të mundur implementimin e Bankingun e Hapur.

Sfida aktuale e këtij projekti me rëndësi kombëtare ka lidhje me certifikatat e sigurisë për PSD2 (QWAC dhe QSEAL).

Ofruesit e shërbimeve të pagesave duhet të mbështeten në certifikatat e kualifikuara për vulat elektronike ose në certifikatat e kualifikuara për autentifikimin e faqeve të internetit, sipas përcaktimeve në legjislacionin për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për të mundësuar komunikimin midis sistemeve.

Aktualisht, në Shqipëri, bazuar në Ligjin Nr. 9880/2008 "Për nënshkrimin elektronik" i ndryshuar, dhe Ligjin Nr. 107/2015 "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara", i ndryshuar, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) regjistron Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimeve

Për të mundësuar Bankingun e Hapur, institucionet financiare **duhet të ndërtojnë komunikime të sigurt midis sistemeve të tyre**, bazuar në rregulloret teknike të Autoriteteve.

të Besuara (OKSHB) të cilët ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) është i vetmi institucion i regjistruar pranë AKCESK si OKSHB, për lëshimin e certifikatave të kualifikuara për nënshkrim elektronik dhe vulë elektronike, megjithatë sipas komunikimeve më të fundit aktualisht nuk është bere akoma e mundur të merren këto certifikata për qëllime të Bankingut të Hapur megjithëse afati fundit ligjor për daljen Live ishte 30 qershor 2024. Nga të dhënat më të fundit, shumë prej institucioneve financiare e kanë gjetur tashmë zgjidhjen e sigurisë së tyre me OKSHB bazuar në zgjidhjet europiane në BE, por nuk është e qartë nëse këto zgjidhje do të pranohen nga AKCESK. Kjo situatë ka ngritur një udhëkryq për të gjithë ato kompani si Easypay, që duan të përparojnë sa më shpejt, por janë të bllokuar deri në zgjidhjen përfundimtare të situatës nga AKSHI dhe AKCESK. Ndërkohe akoma nuk dihet nëse AKSHI do ofrojë të dyja llojet e certifikatave të sigurisë që kërkohen nga bankat, QWAC dhe QSEAL, bazuar në ligjin e ri të Pagesave apo vetëm njërin prej tyre...

SIGURIA DHE SCA (AUTENTIFIKIMI I THELLUAR I KLIENTIT) NË BANKINGUN E HAPUR

Në kuadër të ofrimit të shërbimeve të Bankingut të Hapur, siguria është

një nga elementët më thelbësor. Për të rritur sigurinë e klientit fundor, por edhe për të përmirësuar eksperiencën e tij, e cila sidomos pas periudhës së pandemisë është rritur mjaftueshëm, një inovacion i rëndësishëm është dhe autentifikimi i thelluar i klientit (SCA, Strong Customer Authentication) për të cilën Banka e Shqipërisë ka aprovuar rregulloren "Për autentifikimin e thelluar të klientit dhe standardet e përbashkëta, të hapura dhe të sigurt të komunikimit" me qëllim vendosjen e standardeve të përbashkëta dhe komunikimit ndërmjet ofruesve të ndryshëm të shërbimeve të pagesave, pagesve dhe përfituesve të pagesës, në lidhje me ofrimin dhe përdorimin e shërbimeve të pagesave, si dhe mbrojtjen e konfidencialitetit dhe integritetit të kredencialeve të personalizuara të sigurisë së përdoruesve të shërbimeve të pagesave.

Autentifikimi i thelluar nënkupton kriteret e sigurisë që duhen përmblusur, në mënyrë që klienti të aksesojë llogarinë e tij online, në një institucion financiar. Rregullorja kërkon që ofruesit e shërbimeve të pagesave të disponojnë mekanizma të monitorimit të transaksioneve, që u mundësojnë atyre zbulimin apo identifikimin e transaksioneve të pagesave të paautorizuara ose me qëllime mashtrimi.

Me gjithë sfidat e mësipërme, rrugëtimi me sukses drejt Bankingut të Hapur dhe digjitalizimit të plotë të sistemit financiar kërkon angazhim dhe bashkëpunim midis të gjithë aktorëve në arritjen e objektivave të përbashkëta për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit; rritje të inovacionit në sektorin financiar, rritje të përfshirjes dhe edukimit financiar, dhe përmirësim të ndjeshëm të eksperiencës së klientit fundor me shërbimet financiare në Shqipëri.

**Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në këtë artikull janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën ose qëndrimin zyrtar të Dhomës Amerikane*

NDIKIMI I PLATFORMAVE ERP NË ZHVILLIMIN E INOVACIONIT NË SHQIPËRI

Gentian Likaj
Communication Progress

Digjitalizimi në Shqipëri përfaqëson një proces të vazhdueshëm i cili dekadën e fundit është kthyer në kryefjalë dhe ka ndikuar dukshëm në përmirësimin e proceseve të punës për institucionet dhe bizneset. Me eksperiencën 25 vjeçare në drejtimin e një prej kompanive më të rëndësishme të inovacionit në Shqipëri, Communication Progress, vizioni ynë për digjitalizimin ka lindur dhe është zhvilluar hershëm. Baza e gjerë e klientëve si dhe përditësimi i vazhdueshëm mbi ekosistemin ICT në Shqipëri, na dhanë mundësinë të analizojmë nevojat reale të tregut si dhe të ndërmarim masa konkrete për t'iu qasur në menyrën e duhur klientit vendas.

Nuk po ndalemi në situatën e tregut para digjitalizimit me mangësi lehtësisht të dukshme, ku platformat software ishin thujtë inekzistente. Sfidat e vërtetë lidhej me zhvillimin e një tregu i cili shfaqej i fragmentuar dhe me shumë nevojë për sisteme të cilat mund të kryenin automatizimin e proceseve të punës.

Shumë institucione publike, private, SME, organizata, vuanin pamundësinë e qëndrimit të një mori informacioni manual ose pjesërisht të digjitalizuar. Përputhshmëria e sistemeve me bazat ligjore në fuqi përfaqësonte një tjetër nevojë emergjente për tregun.

Në vitin 2012, bashkë me një ekip të dedikuar të zhvilluesve, analistëve dhe specialistëve të fushës, në Communication Progress u krijua IMPRO, një produkt autentik softuerik i cili është pjesë e produkteve ERP (Enterprise Resource Planning) dhe është krijuar për



Sfidat e vërtetë lidhej me zhvillimin e një tregu i cili shfaqej i fragmentuar dhe me shumë nevojë për sisteme të cilat mund të kryenin automatizimin e proceseve të punës.

të menaxhuar të gjitha operacionet dhe burimet e një kompanie apo institucioni nga një ndërfaqe e vetme. Sistemi automatizon proceset e punës, qëndron informacionin, duke siguruar saktësinë e tij dhe përmirëson ndjeshëm shpejtësinë e komunikimit në të gjitha nivelet e biznesit.

IMPRO është i përshtatur tërësisht me standardet kombëtare të kontabilitetit, standardet ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS), ligjet fiskale dhe Kodin e Punës.

Sistemi integrohet lehtësisht me direktorinë aktive, nga ku përdoruesit mund të identifikohen me të njëjtat kredenciale që ata identifikohen në kompjuterat e tyre. Një tjetër veçori e sistemit është komunikimi i qëndrueshëm me platformën, përshtatja native me pajisje fundore, terminale dhe aplikacione mobile. IMPRO suporton krijimin e niveleve të afërta të konfigurueshme sipas përmbajtjes dhe roleve, dhe ka të integruar modulën e njoftimeve email/sms/whatsapp për aktivitetet/proceset përkatëse. Në çdo ambient pune ekziston mundësia e bashkëngjitjes së dokumentave dhe ruajtjes së tyre në skedë në formën e një arkive elektronike. Zgjidhja mund të integrohet në mënyrë native me hartat duke

suportuar mundësinë e përdorimit të proceseve mbi to.

IMPRO u vjen në ndihmë strukturave drejtuese duke krijuar raporte në formë dashboard të personalizuar dhe duke dhënë mundësinë e monitorimit, vlerësimin dhe analizës së situatës në çdo sektor, në kohë reale. Platforma operon në përputhje me direktivat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve duke u integruar dhe realizuar në kohë reale deklarimin e faturave online (procesi i fiskalizimit).

Sfidat e së ardhmes në ekosistemin digjital ne i shohim në mbrojtjen nga sulmet kibernetike, një fenomen gjithnjë e më shumë prezent. Në paketën e zgjidhjeve që Communication Progress ofron, siguri i një infrastrukture mbështetëse për platformat, "të blinduar" në terma sigurie dhe performance, mbetet prioriteti i yni.

**Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në këtë artikull janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën ose qëndrimin zyrtar të Dhomës Amerikane*